



Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional

Agjencia Për Mbikëqyrje të
Financimit Kapital të Sigurimit Pensional
Nr. 01-1623/4
14.11.2019-viti
SHKUP

**PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN
E AGJENCISË PËR MBIKËQYRJE TË
FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT
PENSIONAL PËR VITIN 2020**

Shkup, nëntor 2019

PËRMBAJTJA

I. AKTIVITETET E AGJENCISË.....	3
1. Çështjet juridike administrative.....	3
1.1. Aktet juridike.....	3
1.2. Aktivitetet lidhur me marrëdhëniet e punës.....	3
1.3. Dhënia e lejeve për dokumentet e parashtruara nga shoqëritë pensionale.....	4
2. Kontrollimi i shoqërive pensionale.....	4
2.1. Kontrollimi jashtë terrenit.....	4
2.2. Kontrollimi në terren.....	5
2.3. Aktivitetet e Komitetit për Vlerësimin e Rreziqeve.....	6
3. Aktivitetet lidhur me anëtarësimin.....	6
3.1. Aktivitetet lidhur me veprimin për ankesat dhe parashtresat.....	6
3.2. Njoftimi i personave të sistemuar.....	7
3.3. Kalimi i anëtarëve nga njëri fond në fondin tjetër të detyrueshëm pensional dhe nga njëri fond në fondin tjetër pensional vullnetar.....	7
4. Proceset e punës dhe pajisja e TI-së.....	7
4.1. Aktivitetet për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve të punës së Agjencisë.....	7
4.2. Mbatja e zgjidhjeve ekzistuese të softuerit për proceset e punës lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional.....	8
5. Organizimi i provimit për agjentë.....	8
5.1. Organizimi i provimit për agjentë.....	8
5.2. Programi i provimit për agjentë.....	9
5.3. Përditësimi i bazës së pyetjeve dhe shembujve praktikë.....	9
6. Analizat statistikore dhe hartimi i raporteve dhe planeve.....	9
6.1. Analizat statistikore.....	9
6.2. Hartimi i raporteve dhe analizave.....	9
6.3. Hartimi i planeve.....	10
6.4. Hartimi i planit strategjik.....	10
7. Projektet zhvillimore të sigurimit pensional me financim kapital.....	10
7.1. Veprimi sipas rekomandimeve të misionit të Bankës Botërore dhe FMN-së pas vlerësimit të kryer të sektorit financiar (FSAP).....	10
7.2. Pjesëmarrja në projektin për krijimin e regjistrit qendror të të siguruarve (SIPA).....	10
8. Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit.....	11
8.1. Bashkëpunimi me institucionet brenda vendit.....	11
8.2. Bashkëpunimi me institucionet jashtë vendit.....	11
8.3. Pjesëmarrja në takimet dhe konferencat e organizuara nga IOPS.....	11
8.4. Aktivitetet lidhur me procesin e aderimit në Bashkimin Evropian.....	11
9. Ekipimi dhe trajnimi.....	12

9.1. Shfrytëzimi i projekteve për misionin konsulent nëpërmjet programit TAIEKS nga Komisioni Evropian.....	12
10. Edukimi i publikut dhe inkluzioni financiar.....	12
11. Prokurimet publike dhe hartimi i planit financiar dhe raporteve financiare.....	13
11.1. Realizimi i prokurimeve publike.....	13
11.2. Hartimi i Planit financiar të Agjencisë.....	13
10.3. Hartimi i raporteve financiare të Agjencisë.....	13
12. Zbatimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë dhe sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacioneve.....	13
13. Revizioni i brendshëm.....	14
14. Përgjegjësia shoqërore.....	14
II. MJETET E PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË AGJENCISË.....	15
III. DISPOZITA E FUNDIT.....	15

PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN
e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital
të Sigurimit Pensional për vitin 2020

Në Programin vjetor për punën e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) përmbahen aktivitetet themelore të cilat, gjatë vitit 2020, do t'i kryejë Agjencia, në pajtim me nenin 47 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

I. AKTIVITETET E AGJENCISË

Agjencia, gjatë vitit 2020, nëpërmjet programit të punës do t'i realizojë aktivitetet si në vijim:

1. Çështjet juridike administrative

1.1. Aktet juridike

Gjatë vitit 2020, Agjencia do të propozojë ndryshime të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, Ligjit për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital dhe Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital.

Agjencia do të vazhdojë me hartimin e akteve të reja dhe ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore ekzistuese të cilat dalin nga ligjet në fushën e sigurimit pensional me financim kapital.

Afati: gjatë vitit 2020

1.2. Aktivitetet lidhur me marrëdhëniet e punës

Agjencia do t'i hartojë planet dhe raportet e rregullta, të tilla si: Plani vjetor i punësimit, Plani vjetor për trajnimet e nëpunësve administrativë, Raporti vjetor për masat e shqiptuara për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore dhe materiale të nëpunësve administrativë, Raporti gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e planit vjetor të punësimit, Raporti gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e planit për trajnimet e nëpunësve administrativë të organizuara nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), Raporti me rang-listën e vlerësimeve vjetore të nëpunësve administrativë, si dhe dokumenteve të tjera në fushën e marrëdhënieve të punës sipas nevojave të saj.

Afati: gjatë vitit 2020

Agjencia do të vazhdojë me hartimin e akteve të reja dhe ndryshimin dhe plotësimin e akteve interne ekzistuese që dalin nga Ligji për marrëdhënie pune, Ligji për siguri dhe shëndet gjatë punës, Ligji për nëpunësit administrativë, Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe ligje të tjera.

Afati: vazhdimisht gjatë vitit 2020

1.3. Dhënia e lejeve për dokumentet e parashtruara nga shoqëritë pensionale

Agjencia do të vazhdojë me dhënien e lejeve / pëlqimeve për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve të parashtruara nga shoqëritë pensionale për: zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Drejtues ose Këshillin Mbikëqyrjes të shoqërisë, statutin e shoqërisë, statutin e fondit të detyrueshëm dhe/ose pensional vullnetar, kontratat me personat juridikë që kryejnë shërbime me letra me vlerë, kontratën me kujdestarin e pronës dhe emërimin e personit udhëheqës ose personit tjetër i cili propozohet të jetë përgjegjës për vendimet e investimeve, menaxhimin e rreziqeve, revizionin e brendshëm, llogaritë individuale, marketingun, kontrollimin e agjentëve dhe llogaritjen e tërheqjeve të programuara.

Afati: gjatë vitit 2020, me kërkesë të shoqërive pensionale

2. Kontrollimi i shoqërive pensionale

Agjencia rregullisht do ta ushtrojë funksionin e vet themelor nëpërmjet kombinimit të kontrollimeve jashtë terrenit dhe në terren të shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale.

2.1. Kontrollimi jashtë terrenit

Me qëllim të perceptimit të problemeve ekzistuese dhe ballafaqimit me paraqitjen e problemeve të reja në punën e shoqërive pensionale, Agjencia do të kryejë kontrollimin jashtë terrenit që përfshin:

- Kontrollimin e anëtarësimit dhe kalimin në fondet pensionale;
- Kontrollimin e të dhënave nga Regjistri i anëtarëve;
- Kontrollimin e ndarjes së kontributeve në llogaritë individuale të anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale;
- Kontrollimin e shumës së kryegjësë, mjeteve personale dhe shumës dhe mjeteve likuide të shoqërive pensionale;
- Kontrollimin e materialeve dhe aktiviteteve për marketing të shoqërive pensionale;
- Kontrollimin e punës së agjentëve të shoqërive pensionale;

- Kontrollimin e kompensimeve që i arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe kujdestarët e pronës;
- Kontrollimin e aktiviteteve investuese të shoqërive pensionale me shfrytëzimin e mjeteve të fondeve pensionale;
- Kontrollimin e vlerësimit të mjeteve të fondeve pensionale;
- Kontrollimin e kontabilitetit dhe raporteve financiare të fondeve pensionale dhe shoqërive pensionale;
- Kontrollimin e raporteve nga revizori i brendshëm, nga personi përgjegjës për menaxhimin e rreziqeve dhe nga aktuari i autorizuar;
- Kontrollimin e transferit të mjeteve midis fondeve pensionale dhe nga fondet pensionale;
- Kontrollimin e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga fondet pensionale;
- Kontrollimin e transaksioneve me letra me vlerë të personave me qasje në informacionet konfidenciale në shoqëritë pensionale dhe kujdestarëve të pronës;
- Kontrollimin e njoftimeve të rregullta në Agjenci;
- Inicimin e procedurave për barazim dhe kërkesave për inicimin e procedurave të kundërvajtjes, dhe
- Kontrollimin e materialeve dhe aktiviteteve në fushën e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Afati: vazhdimisht gjatë vitit 2020

2.2. Kontrollimi në terren

Kontrollimi në terren do të zbatohet drejtpërdrejt në ambientet e punës së shoqërisë pensionale dhe kujdestarit të pronës nëpërmjet intervistave me ekipin menaxhues dhe me punonjësit në shoqërinë pensionale dhe me kujdestarin e pronës, ndërsa mbaron në ambientet e Agjencisë, nëpërmjet analizimit të dokumenteve të dorëzuara nga shoqëria dhe nga kujdestari i pronës dhe hartimit të Raportit dhe Procesverbalit nga kontrollimi i zbatuar.

Kontrollimi do të bazohet në metodën e mbikëqyrjes mbi vlerësimin e rrezikut dhe do t'i përfshijë fushat në vijim:

- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e shoqërisë;
- Rreziqet financiare;
- Rreziqet operative;
- Rreziqet lidhur me kompensimet e shoqërive;
- Rreziqet lidhur me të dhënat e anëtarëve;
- Rreziqet për pagesën e mjeteve, dhe
- Rreziqet lidhur me mirëkuptimin dhe me ndërgjegjësimin e publikut.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2020

Gjatë kontrollimit në terren i punës së shoqërive pensionale, do të zbatohet edhe kontrollimi në terren i punës së kujdestarëve të pronës së fondeve pensionale, për vitet 2019 dhe 2020. Kontrollimi do të bazohet në metodën e mbikëqyrjes në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe do t'i përfshijë fushat në vijim:

- Llogaritjet e neto-mjeteve dhe njësisë së kontabilitetit të fondeve pensionale;
- Ruajtja dhe evidenca e mjeteve të fondeve pensionale;
- Ndjekja e kufizimeve gjatë investimit të mjeteve të fondeve pensionale dhe harmonizimi i tyre me rregullativën ligjore dhe nënligjore;
- Ndjekja dhe investimi për ngjarjet korporative.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2020

Në kuadër të kontrollimeve në terren do të zbatohet edhe kontrollimi i bashkëpunëtorëve të punës së shoqërive pensionale nga aspekti i harmonizimit të tyre me rregullativën ligjore dhe nënligjore.

Afati: tremujori i dytë dhe i tretë i vitit 2020

2.3. Aktivitetet e Komitetit për Vlerësimin e Rreziqeve

Si pjesë e vlerësimit të rregullt dhe revidimit të rreziqeve në sigurimin pensional me financim kapital, në kuadër të Agjencisë ekziston Komiteti për Vlerësimin e Rreziqeve, i cili përbëhet nga anëtarët e brendshëm të Këshillit të Ekspertëve, nga kolegji i Agjencisë dhe nga udhëheqësit e seksioneve në kontrollimin financiar dhe në kontrollimin institucional. Komiteti kryen aktivitetet si në vijim:

- Vlerësimin dhe revizionin e rreziqeve në sigurimin pensional me financim kapital dhe përcaktimin e ekzistimit ose paraqitjes së mundshme të rreziqeve të reja;
- Shqyrtimin e raporteve dhe procesverbaleve të miratuara nga kontrollimi i kryer;
- Shqyrtimin e zhvillimeve më të reja në sigurimin pensional me financim kapital ose në tregjet financiare që mund të ndikojnë në vlerësimet e rreziqeve;
- Shqyrtimin e efektivitetit të strategjive për zbutjen e rreziqeve dhe në bazë të saj, propozimin e ndryshimeve të strategjisë dhe planit vjetor të Agjencisë.

Afati: gjatë vitit 2020

3. Aktivitetet lidhur me anëtarësimin

3.1. Aktivitetet lidhur me veprimin për ankesat dhe parashtresat

Agjencia do të vazhdojë me veprimin për ankesat dhe parashtresat me qëllim të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të tanishëm dhe anëtarëve të ardhshëm të fondeve pensionale. Agjencia do të veprojë për parashtresat e: të siguruarve, anëtarëve të fondeve të detyrueshme ose vullnetare pensionale, agjentëve, shoqërive pensionale dhe

personave të tjerë të cilët konsiderojnë se janë shkelur të drejtat e tyre nga sigurimi pensional me financim kapital. Duke vepruar për ankesat dhe parashtresat, Sektori i Kontrollimit Institucional do të propozojë marrjen e aktiviteteve dhe masave konkrete. Sektori i Kontrollimit Institucional do të mbajë procedura për realizimin e të drejtave të anëtarëve të fondeve pensionale dhe, në përgjithësi për shkeljen e të drejtave dhe interesave të të siguarve dhe anëtarëve të fondeve të detyrueshme ose vullnetare pensionale.

Afati: gjatë vitit 2020

3.2. Njoftimi i personave të sistemuar

Agjencia rregullisht do t'i njoftojë të siguarit e sistemuar përkohësisht në fondet e detyrueshme pensionale për atë se kanë afat ligjor prej tre muaj të lidhin kontratë për anëtarësim me njërin nga të tria shoqëritë pensionale.

Afati: gjatë vitit 2020

3.3. Kalimi i anëtarëve nga njëri fond në fondin tjetër të detyrueshëm pensional dhe nga njëri fond në fondin tjetër pensional vullnetar

Në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, Agjencia ka rol kontrollues në procesin e kalimit të anëtarëve nga njëri fond në fondin tjetër të detyrueshëm pensional. Si rrjedhojë, Agjencia do të bëjë kontrollimin në mënyrën në të cilën shoqëritë pensionale në mënyrë të ndërsjellë e zbatojnë kalimin e anëtarëve nga njëri fond në fondin tjetër të detyrueshëm pensional. Agjencia do të zbatojë aktivitete kontrolluese përkatëse edhe në procedurën për kalimin e anëtarit nga njëri fond në fondin tjetër pensional vullnetar.

Afati: gjatë vitit 2020

4. Proceset e punës dhe pajisja e TI-së

4.1. Aktivitetet për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve të punës së Agjencisë

Për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve të punës së Agjencisë, në vitin 2020, lidhur me funksionimin e shtyllës së dytë dhe të tretë pensionale (përditësimi dhe përparimi) do të përfshihen aktivitetet si në vijim:

- Ndjekja dhe përditësimi i proceseve të automatizuara të punës dhe aplikacioneve të softuerit që janë pjesë e kontrollimit jashtë terrenit të shoqërive pensionale;
- Përparimi i proceseve pas shqyrtimit të problemeve në praktikë ose me kërkesë të institucioneve të involvuara;

- Analizimi dhe aftësimi i proceseve ekzistuese të punës dhe aplikacioneve të softuerit në pajtim me ndryshimet për aktet ligjore dhe nënligjore;
- Identifikimi i proceseve të reja të punës dhe kontrollimeve të reja në kuadër të Agjencisë që dalin nga zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë së Informacioneve në pajtim me standardin ISO/IEC 27001:2013;
- Zhvillimi i proceseve për mbikëqyrjen informatike të bazuar në vlerësimin e rreziqeve.

Afati: gjatë vitit 2020

4.2. Mbajtja e zgjidhjeve ekzistuese të softuerit për proceset e punës lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional

Mbajtja e zgjidhjeve ekzistuese të softuerit për proceset e punës lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë, në bashkëpunim me shtëpinë e softuerit është zhvillimi i planifikuar i zgjidhjeve të reja të softuerit në bazë të proceseve të punës të dala nga zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë së Informacioneve në pajtim me standardin ISO/IEC 27001:2013 si dhe propozim-zgjidhjet për ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital dhe ndryshimet e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Afati: gjatë vitit 2020

5. Organizimi i provimit për agjentë

5.1. Organizimi i provimit për agjentë

Në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital dhe Rregulloren për agjentë të shoqërive pensionale, Agjencia do ta zbatojë provimin për marrjen e cilësisë së agjentëve, dy herë në vit do të lëshojë certifikatë për provimin e dhënë për agjent dhe do të bëjë regjistrimin e agjentëve në Regjistrin e agjentëve. Provimi do të jepet për gjithë materien në fushën e sigurimit pensional me financim kapital dhe pagesën e pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital. Sesionet e provimeve do të organizohen nëse ka interesim nga shoqëritë pensionale për paraqitjen e kandidatëve për të dhënë provimin me qëllim të marrjes së cilësisë së agjentit dhe regjistrimin në Regjistrin e agjentëve. Provimin teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror, i zgjedhur nga Agjencia.

Në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, Agjencia do të bëjë edhe revizionin e çdo provimi të zbatuar, për çka do të hartojë raport.

Afati: tremujori i dytë dhe i katërt i vitit 2020

5.2. Programi i provimit për agjentë

Agjencia do të bëjë përditësimin e Programit për dhënien e provimit për agjentë të shoqërive pensionale në pajtim me ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore relevante.

Afati: gjatë vitit 2020

5.3. Përditësimi i bazës së pyetjeve dhe shembujve praktikë

Agjencia do të bëjë revizionin dhe përditësimin e bazës së pyetjeve dhe bazës së shembujve praktikë, përkatësisht do të ndryshojë ose plotësisht do të mënjanojë dhe zëvendësojë me të paktën 30% të reja nga baza e pyetjeve dhe shembujve praktikë, të paktën dy herë në vit.

Afati: gjatë vitit 2020

6. Analizat statistikore dhe hartimi i raporteve dhe planeve

6.1. Analizat statistikore

Agjencia do të bëjë analiza statistikore të sigurimit pensional me financim kapital, përkatësisht funksionimit të shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe do të bëjë njoftimin statistikor dhe analitik, që nënkupton hartimin dhe publikimin në faqen e internetit të Agjencisë, të:

- buletinëve mujorë,
- raporteve statistikore tremujore, dhe
- raportit statistikor vjetor.

Afati: gjatë vitit 2020

6.2. Hartimi i raporteve dhe analizave

Agjencia do të hartojë raporte dhe analiza të sigurimit pensional me financim kapital, si në vijim:

- Raport për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital për vitin 2019.

Afati: tremujori i dytë i vitit 2020

• Kërkime dhe analiza dhe raporte krahasuese për temat që janë relevante për sigurimin pensional me financim kapital.

Afati: gjatë vitit 2020

- Raporte për ndjekjen e risive në fushën e sigurimit pensional me financim kapital.

Afati: gjatë vitit 2020

- Raport për punën e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional në vitin 2019.

Afati: tremujori i parë i vitit 2020

6.3. Hartimi i planeve

Agjencia do të hartojë Program vjetor për punën e Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional për vitin 2021.

Afati: tremujori i katërt i vitit 2020

6.4. Hartimi i planit strategjik

Agjencia do të hartojë Plan strategjik të Agjencisë për periudhën 2021 – 2023.

Afati: tremujori i katërt i vitit 2020

7. Projektet zhvillimore të sigurimit pensional me financim kapital

7.1. Veprimi sipas rekomandimeve të misionit të Bankës Botërore dhe FMN-së pas vlerësimit të kryer të sektorit financiar (FSAP)

Agjencia do të ndërmarrë aktivitete në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të misionit të FSAP-së së Bankës Botërore.

Afati: gjatë vitit 2020

7.2. Pjesëmarrja në projektin për krijimin e regjistrit qendror të të siguarve (SIPA)

Agjencia do të marrë pjesë në aktivitetet lidhur me projektin e Bankës Botërore për regjistrin e unifikuar qendror dhe sistemin për regjistrimin e të dhënave nga sigurimi pensional dhe social.

Afati: gjatë vitit 2020

8. Bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit

8.1. Bashkëpunimi me institucionet brenda vendit

Agjencia do të vazhdojë ta avancojë bashkëpunimin me institucionet brenda vendit, me të cilat Agjencia ka nënshkruar kontrata të bashkëpunimit në bazë të rregullt

ose sipas nevojës me qëllim që të sigurojë mbikëqyrje efikase. Gjithashtu, Agjencia do të vazhdojë me iniciimin e nënshkrimit të kontratave të reja të bashkëpunimit.

Afati: gjatë vitit 2020

8.2. Bashkëpunimi me institucionet jashtë vendit

Agjencia do të vazhdojë ta avancojë bashkëpunimin me institucionet jashtë vendit, me të cilat Agjencia ka nënshkruar kontrata të bashkëpunimit në bazë të rregullt ose sipas nevojës me qëllim që të sigurojë mbikëqyrje efikase. Gjithashtu, Agjencia do të vazhdojë me iniciimin e nënshkrimit të kontratave të reja të bashkëpunimit.

Agjencia do të vazhdojë me iniciimin e takimeve me rregullatorët e fondeve pensionale nga vendet e tjera, me qëllim të shkëmbimit të përvojave në fushën e sistemit pensional.

Afati: gjatë vitit 2020

8.3. Pjesëmarrja në takimet dhe konferencat e organizuara nga IOPS

Agjencia do të vazhdojë të marrë pjesë në takimet dhe konferencat e organizuara nga IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë) ku Agjencia është anëtare që nga viti 2007.

Afati: Në terminet e përcaktuara në vitin 2020

8.4. Aktivitetet lidhur me procesin e aderimit në Bashkimin Evropian

Agjencia do të marrë pjesë në hartimin e Programit kombëtar për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe do të japë kontribut në Raportin për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të marrë pjesë në takimet e punës dhe nënkomitetin për tregun e brendshëm dhe konkurrencën dhe nënkomitetin për çështjet financiare ekonomike dhe statistikën.

Afati: gjatë vitit 2020

9. Ekipimi dhe trajnimi

9.1. Vizita e trajnimeve profesionale e punonjësve të Agjencisë

Punonjësit në Agjenci do të vazhdojnë të vizitojnë trajnime profesionale në fushën e TI-së, rregullave, mbikëqyrjes së shoqërive dhe fondeve pensionale, tregjeve të kapitalit, aktuarisë, ISMS-së, standardeve ISO, etj.

Gjithashtu, çdo punonjës vazhdimisht do të vizitojë trajnime gjenerike të parashikuara në Programin vjetor të trajnimeve të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), në pajtim me planin individual për përsosjen profesionale.

Afati: gjatë vitit 2020

9.1. Shfrytëzimi i projekteve për misionin konsulent nëpërmjet programit TAIEKS nga Komisioni Evropian

Agjencia do të vazhdojë të parashtojë kërkesa në Komisionin Evropian për shfrytëzimin e projekteve për misionin konsulent nëpërmjet programit TAIEKS.

Afati: gjatë vitit 2020

10. Edukimi i publikut dhe inkluzioni financiar

Në pajtim me obligimet ligjore, Agjencia në vitin 2020 do ta vazhdojë komunikimin me publikun me qëllim të promovimit të saj të vazhdueshëm në fushën e sigurimit pensional me financim kapital. Agjencia do të zbatojë aktivitete në drejtim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për sigurimin pensional me financim kapital në bazë të Planit të hartuar për informimin e publikut për sigurimin pensional me financim kapital për vitin 2020.

Aktivitetet: intervista, konferenca për shtyp, dita e ndërgjegjësimit pensional – 15 shtatori, hartimi i informatorëve tremujorë E-MAPAS, edukime për publikun, fushata informatike, deklarata dhe njoftime për publikun në mediat e shkruara dhe elektronike, ndjekja e publikimeve mediatike lidhur me MAPAS-in dhe përditësimi i rregullt i faqes së internetit të Agjencisë. Agjencia do të marrë pjesë në punën e Trupit Koordinues për Edukimin Financiar dhe Inkluzionin Financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në të cilin anëtarësohen dhe vendosin bashkëpunim me Bankën Popullore, Ministrinë e Financave, Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimit, Agjencinë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional dhe Komisionin për Letra me Vlerë.

Afati: gjatë vitit 2020

11. Prokurimet publike dhe hartimi i planit financiar dhe raporteve financiare

11.1. Realizimi i prokurimeve publike

Për nevojat e Agjencisë, Sektori i Çështjeve Administrative Financiare do të zbatojë aktivitete për realizimin e prokurimeve publike, në bazë të Planit vjetor për prokurimet publike të miratuar paraprakisht, në pajtim me Ligjin për prokurimet publike.

Afati: vazhdimisht gjatë vitit 2020

11.2. Hartimi i Planit financiar të Agjencisë

Spektori i Çështjeve Administrative Financiare do të hartojë Plan financiar të Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pënsional për vitin 2021.

Afati: tremujori i katërt i vitit 2020

11.3. Hartimi i raporteve financiare të Agjencisë

Spektori i Çështjeve Administrative Financiare do të hartojë raporte financiare të Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pënsional për vitin 2019.

Afati: gjatë vitit 2020

12. Zbatimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë dhe sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacioneve

Në pajtim me obligimet e sistemit për menaxhimin e cilësisë, Agjencia në vitin 2020 do të vazhdojë ta mbajë sistemin për menaxhimin e cilësisë dhe menaxhimin e dokumenteve të cilat dalin nga standardet ISO. Në vitin 2020 do të zbatohen kontrollimet e brendshme të rregullta të sistemit për menaxhimin e cilësisë, sipas Radhitjes së Kontrollimit të përgatitur paraprakisht për vitin 2020, si dhe do të zbatohet kontrollimi i jashtëm për risertifikimin.

Afati: gjatë vitit 2020

13. Revizioni i brendshëm

Revizioni i brendshëm është aktivitet i pavarur i dhënies së bindjes dhe këshillës objektive, të vendosur me qëllim që të kontribuojë për rritjen e vlerës dhe përmirësimin e punës së subjektit.

Revizioni i brendshëm do t'i kryejë punët që kanë të bëjnë me: planifikimin, organizimin dhe zbatimin e revizioneve në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore dhe standardet ndërkombëtare për revizionin e brendshëm. Gjithashtu, revizioni i brendshëm do t'i realizojë qëllimet e veta themelore nëpërmjet vlerësimit sistematik dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rreziqeve, adekuatshmërisë dhe efektivitetit të kontrollimeve të brendshme dhe harmonizimit të punës me rregullat në fuqi, aktet dhe procedurat interne të Agjencisë. Revizioni i brendshëm kryen revizione dhe harton raporte të revizorit, në bazë të planit strategjik dhe vjetor për revizionin e brendshëm.

Afati: gjatë vitit 2020

14. Përgjegjësia shoqërore

Agjencia gjatë vitit 2020 planifikon të ndërmarrë aktivitete për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e mjedisit jetësor, me mbështetjen e shoqërisë sonë nëpërmjet marrëdhënies së përgjegjshme ndaj mjedisit dhe përparimit ekologjik. Agjencia do të vendos bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, me shoqatat dhe institucionet dhe do të organizojë eko-aksione të përbashkëta me qëllim të përmirësimit të mjedisit tonë dhe mjedisit jetësor.

Afati: gjatë vitit 2020

II. MJETET E PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË AGJENCISË

Aktivitetet nga Programi vjetor për punën e Agjencisë parashihet të financohen nga të ardhurat personale që Agjencia do t'i realizojë gjatë vitit 2020, në pajtim me dispozitat për financimin e Agjencisë, të përcaktuara me nenin 56 paragrafi (3) të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital. Të ardhurat dhe shpenzimet e vlerësuara të Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional janë prezantuar në Planin financiar vjetor për vitin 2020, me arsyetimin për lartësinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara.

III. DISPOZITA E FUNDIT

Ky program hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e publikimit në tabelën e shpalljes dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve,

Maksud Ali



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Maksud Ali'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the following text: 'Сeбepнa Mакeдoнcкa Рeпyблнкa' (Republic of North Macedonia), 'AГEHCИJA ПEР MБИКEҚYPJE TË ФИНАНСИМИТ КАПИТАЛ ТË СИГУРИМИТ ПЕНСИОНАЛ' (Agency for Pension Insurance with Capital Financing), 'Шкyп' (Skopje), and 'AГEHCИJA ПEР MБИКEҚYPJE TË ФИНАНСИМИТ КАПИТАЛ ТË СИГУРИМИТ ПЕНСИОНАЛ' (Agency for Pension Insurance with Capital Financing). The stamp also features the coat of arms of North Macedonia.

3.2	Njoftimi i personave të sistemuar	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	
3.3	Kalimi i anëtarëve nga njëri fond në fondin tjetër të detyrueshëm pensional dhe nga njëri fond në fondin tjetër pensional vullnetar	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	
4	Proceset e punës dhe pajisja e TI-së																		
4.1	Aktivitetet për zhvillimin e mëtejshëm të proceseve të punës së Agjencisë	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	
4.2	Mbajtja e zgjidhjeve ekzistuese të softuerit për proceset e punës lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	
5	Organizimi i provimit për agjentë																		
5.1	Organizimi i provimit për agjentë															V	V	V	V

